



Datë: 26.05.2025  
Numër Protokolli: 3482/2025

A.nr.551/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari–anëtarë, me Çlirim Zeka-në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.551/2025 të datës 25.03.2025 të parashtruar nga ankuesja M.E. të cilën me autorizim e përfaqëson avokati Faton Fetahu, kundër organit të punësimit Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “*Vlerësim i rezultateve në punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.05.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.551/2025 e datës 25.03.2025 e parashtruar nga ankuesja M.E.

**II. Mbetet në fuqi** Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 27.02.2025 nga Udhëheqësja e Divizionit për Parandalim dhe Integrim Shoqëror në Divizionin për Parandalim dhe Integrim Shoqëror në Departamentin e Rinisë në kuadër të Ministrinë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

## A r s y e t i m

Nëpunësja civile M.E. (*në tekstin e mëtejme referuar* ankuesja) më datë 25.03.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2005/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë të datës 27.02.2025, nga Udhëheqësja e Divizionit për Parandalim dhe Integrim Shoqëror në Divizionin për Parandalim dhe Integrim Shoqëror në Departamentin e Rinisë në kuadër të Ministrinë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.04.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa Këshilli më datë 07.05.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër VK/2025 me datë 08.05.2025 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 2005/2025 të datës 25.03.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizim nga M.E. për F.F.i datës 27.08.2024; Vendim i KPMSHCK me numër protokolli 852/2025 i datës 05.02.2025; Vendim i KPMSHCK me numër protokolli 5709/2024 i datës 28.10.2024; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i M.E. i datës 31.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i M.E. i datës 04.03.2024; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil i M.E. i datës 27.02.2025; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 22-29 dhjetor 2023; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 08-14 shkurt 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 15-21 shkurt 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 22-28 mars 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 29 mars dhe 04 prill 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 05-11 prill 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 12-18 prill 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 19-25 prill 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 10-16 prill 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 11-13 Qershor 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 14-20 Qershor 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 21-27 Qershor 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 28 Qershor dhe 04 Korrik 2024; Raporti dyjavor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 08-18 Korrik 2024; Raporti dyjavor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 12-15 Gusht dhe 16-22 Gusht 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 23-29 Gusht 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 30 Gusht dhe 05 Shtator 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsish i datës 05-12 Shtator 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor i datës 07-10 tetor 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor i datës 11-17 tetor 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor i datës 17-24 tetor 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor i datës 24-31 tetor 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor i datës 31 tetor dhe 07 Nëntor 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor i datës 07-14 Nëntor 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor i datës 14-22 Nëntor 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor i datës 02-06 Dhjetor 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor i datës 09-13 Dhjetor 2024; Raporti javor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor i datës 16-20 Dhjetor 2024; E-mail nga F.F. për [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net) i datës 26.03.2025; Letërnjoftim i M.E.; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 07.04.2025; Përgjigje në ankesë i datës 07.05.2025; E-mail nga T.B. për Sh.I. i datës 29.04.2025; Akt Emërim i M.E. i datës 03.02.2011; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 04.08.2012; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 05.03.2024; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i M.E. i datës 28.02.2024; Dëshmi nëse ankuesja nuk ka qenë bashkpunuese me palët si dhe komunikimi me kolegët e punës e-mailat; Dëshmi se ankuesja ka pasur ndonjë detyrë nga mbikqyrësja e që nuk e ka përfunduar e-mailat; Raportet javore të ankueses E-mailat për vitin 2024; vendim për pushim i simbnj për M.E. i datës 22.01.2024; vendim për pushim i simbnj për M.E. i datës 09.01.2024; pushim mjekësor i M.E. i datës 22.03.2024; E-mail nga Xh.B. për K.Xh. etj. i datës 13.03.2025; E-mail nga Z.S. për M.E. i datës

14.03.2025; E-mail nga M.E. për Z.S. i datës 06.03.2025; E-mail nga Xh.B. për M.E. i datës 23.04.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 23.04.2024; E-mail nga Xh.B. për M.E. i datës 23.04.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 23.04.2024; E-mail nga Xh.B. për M.E. i datës 23.04.2024; E-mail nga Xh.B. për Z.S. i datës 02.05.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 02.05.2024; E-mail nga D.D. për M.E. i datës 30.04.2024; E-mail nga M.E. për D.D. i datës 29.04.2024; E-mail nga Xh.B. për M.E. i datës 23.04.2024; E-mail nga Xh.B. për F.H. i datës 24.04.2023; E-mail nga V.J. për F.H. etj. i datës 14.04.2023; E-mail nga M.N. për V.J. i datës 14.04.2023; E-mail nga L.A. për M.N. i datës 12.04.2023; E-mail nga L.A. për M.K. etj. i datës 09.03.2023; E-mail nga D.D. për F.H. i datës 27.04.2023; E-mail nga F.H. për D.D. i datës 26.04.2023; E-mail nga Xh.B. për F.H. i datës 26.04.2023; E-mail nga arkiva mkrs për M.E. etj. i datës 25.04.2024; Vendim i U.d. sekretarit të përgjithshëm të MKRS me numër protokolli 02/95 i datës 24.04.2024; E-mail nga V.J. për D.B. i datës 23.04.2024; E-mail nga M.E. për V.J. i datës 15.04.2024; E-mail nga V.J. për M.E. i datës 05.04.2024; E-mail nga Xh.B. për V.J. i datës 04.04.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 04.04.2024; E-mail nga V.J. për F.K. i datës 14.05.2024; E-mail nga arkiva mkrs për V.J. i datës 25.04.2024; E-mail nga arkiva mkrs për M.E. etj. i datës 25.04.2024; E-mail nga Xh.K. për Xh.B. etj. i datës 27.06.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 20.05.2024; E-mail nga Sh.B. për Xh.B. etj. i datës 20.10.2023; E-mail nga Sh.B. për Z.S. i datës 23.10.2023; E-mail nga M.E. për Xh.B. etj. i datës 12.04.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. etj. i datës 18.04.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. etj. i datës 12.04.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. etj. i datës 15.08.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 22.08.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 20.06.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 13.06.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 23.05.2024; E-mail nga M.E. për Z.S. i datës 29.08.2024; E-mail nga M.E. për Z.S. etj. i datës 05.09.2024; E-mail nga M.E. për Z.S. i datës 12.09.2024; E-mail nga M.E. për Z.S. etj. i datës 06.12.2024; E-mail nga M.E. për K.Xh. etj. i datës 13.12.2024; E-mail nga K.Xh. për Z.S. etj. i datës 13.12.2024; E-mail nga Z.S. për M.E. etj. i datës 16.11.2023; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 16.11.2023; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 20.06.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 13.06.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 23.05.2024; E-mail nga M.E. për Z.S. i datës 29.08.2024; E-mail nga M.E. për Z.S. etj. i datës 05.09.2024; E-mail nga M.E. për Z.S. i datës 12.09.2024; E-mail nga M.E. për Z.S. etj. i datës 06.12.2024; E-mail nga M.E. për K.Xh. etj. i datës 13.12.2024; E-mail nga K.Xh. për Z.S. i datës 13.12.2024; E-mail nga M.E. për K.Xh. i datës 20.12.2024; E-mail nga K.Xh. për Z.S. etj. i datës 20.12.2024; E-mail nga M.E. për E.S. etj. i datës 24.10.2024; E-mail nga M.E. për Z.S. i datës 17.10.2024; E-mail nga M.E. për Z.S. etj. i datës 10.10.2024; E-mail nga L.B. për M.E. etj. i datës 22.08.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 22.08.2024; E-mail nga M.E. për L.B. etj. i datës 22.08.2024; E-mail nga L.B. për M.E. etj. i datës 22.08.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 22.08.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 16.05.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 25.04.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 21.03.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 11.04.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 04.04.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 14.03.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 28.03.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 18.04.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 02.05.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 25.07.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 27.06.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 18.07.2024; E-mail nga M.E. për Xh.B. i datës 04.07.2024; E-mail nga K.Xh. për Z.S. etj. i datës 20.12.2024; E-mail nga M.E. për K.Xh. etj. i datës 12.12.2024; Raporti vjetor i Sektorit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor sepsh Janar Dhjetor 2024; Vendim për shtyrje të afatit i KPMSHCK me numër protokolli 3089/2025 i datës 08.05.2025;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 03.02.2011 mbanë pozitën e punës “Zyrtare për Edukim Shëndetësor” në Divizionin për Parandalim dhe Integrim Shoqëror në Departamentin e Rinisë në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se Udhëheqësja e Divizionit për Parandalim dhe Integrim Shoqëror në Divizionin për Parandalim dhe Integrim Shoqëror në Departamentin e Rinisë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 27.02.2025 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2024 dhe atë në nivelin e përgjithshëm të vlerësimit ka nevojë për përmirësim.

Ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë të datës 27.02.2025 nga Udhëheqësja e Divizionit për Parandalim dhe Integrim Shoqëror në Divizionin për Parandalim dhe Integrim Shoqëror në Departamentin e Rinisë në kuadër të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit me pretendimin ankimor se vlerësimi i rezultateve të punës është krejtësisht subjektiv dhe në mungesë të plotë të parimit të objektivitetit pasi që ky vlerësim është hartuar pikërisht nga subjekti i ankueses i cili ka inicuar disa procedura disiplinore e të cilat janë konstatuar të pabazuara nga KPMSHCK në vështrim të përmbajtjeve të vlerësimit të aftësive përkatëse në formularin e vlerësimit të gjitha komentet dhe arsyet për vlerësim negativ lidhen ekskluzivisht me çështjet të cilat mbikëqyrësja i ka ngritur edhe në të kaluarën përmes kërkesës për inicim të procedurës disiplinore e të cilat janë konstatuar të pabazuara nga ana e Këshillit, për të argumentuar faktin se vlerësimi është bërë në mungesë të parimit të objektivitetit dhe se i njëjti ndërlidhet me emrin e ankuese e cila tash e disa kohë është objekt i qasjes selektive dhe dëmtuese ndaj saj, gjithashtu ju vëmë në dijeni faktin se ankuesja dy vitet paraprake rrjedhimisht në vlerësimin e vitit 2023 është vlerësuar me notën e përgjithshme 4 dhe në vitin 2024 është vlerësuar me notën e përgjithshme 3.7, konsiderojmë si të paqëndrueshme komentet e vlerësueses në lidhje me realizimin e objektivave, vlerësimit të aftësive profesionale gjegjësisht komentet mbi rubrikën e komunikimit efektiv bashkëpunimit dhe punës në ekip adaptimi dhe fleksibiliteti si dhe respektimi i rregullave dhe procedurave, kërkon ti aprovohet në tërësi ankesa si e bazuar të anulohet vlerësimi i rezultateve në punë dhe të obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit që të bëjë zbatimin brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij duke e obliguar mbikëqyrësen e drejtpërdrejt të ankueses që të bëjë rivlerësimin e rezultateve në punë duke zbatuar udhëzimet e dhëna nga KPMSHCK dhe të njoftojë me shkrim Këshillin pas ndërmarrjes së të gjitha veprimeve.

Fillimisht Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses, konstaton se e njëjta është e lejueshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 17 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe e njëjta është e pranueshme në kuptim të nenit 127 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore Kolegji i Këshillit, ju referuar Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me theks të veçantë nenit 52, me të cilin është përcaktuar se: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunëses/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësive të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të paracaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunëses/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i*

*i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 7. Performanca e nëpunëses/it civil të kategorisë profesionale dhe kategorisë së specialistes/it vlerësohet nga mbikëqyrësja/ie saj/tij i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 8..10. Përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, merr pjesë, mbështet dhe vëzhgon çdo proces të vlerësimit. 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin. 12. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore zhvillojnë takim me nëpunësen/in për vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët” dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave fillimisht ka konstatuar se pozita të cilën e mbanë ankuesja “Zyrtare për Edukim Shëndetësor” në Divizionin për Parandalim dhe Integrim Shoqëror në Departamentin e Rinisë në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në përshkrimin e detyrave të punës raporton tek Udhëheqësi i Divizionit për Parandalim dhe Integrim Shoqëror.

Kolegji i Këshillit, bazuar në shkresat e lëndës të dërguara nga organi i punësimit gjatë shqyrtimit të përgjigjes në ankesë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka gjetur se ankuesja në pjesën më të madhe të vitit 2024 raportet javore i ka dërguar tek Drejtori i Departamentit të Rinisë në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit duke anashkaluar apo tejkaluar mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj deri në momentin kur Drejtori i Departamentit ka kërkuar të respektohet hierarkia institucionale.

Kolegji i Këshillit ka gjetur se Drejtori i Departamentit të Rinisë në kuadër të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit përmes e-mailit të datës 13.03.2025 ka bërë Njoftim zyrtar për stafin e Departamentit të Rinisë për të cilin ka qenë e njoftuar edhe ankuesja, si në vijim citoj: *Me qëllim të sigurimit të një komunikimi efektiv dhe transparent ju lutemi që të respektoni me kujdes aktet administrative për komunikim të brendshëm dhe jashtëm. Ky udhëzim vlen për të gjithë anëtarët e stafit të Departamentit të Rinisë dhe ka për qëllim të standardizojë procedurat e komunikimit duke garantuar që informacioni të shpërndahet në mënyrë të qartë dhe të përshtatshme sipas hierarkisë dhe këtë shqetësim e shprehi me rekomandim të Sekretarit të Përgjithshëm, komunikimi të jetë profesional dhe i respektueshëm, të ruhet konfidencialiteti i të dhënave sensitive.*

Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesja me datë 20.05.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e Departamentit të Rinisë në kuadër të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit se nuk mund të vij në punë se është e sëmurë, duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj.

Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesja me datë 04.04.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e Departamentit të Rinisë në kuadër të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit për raportin javor për datat 29 mars deri 04 prill 2024 duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj, me datë 22.08.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e Departamentit të Rinisë për raportin dyjavor për datat 12-15 gusht dhe 16-22 gusht 2024 duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj, me datë 20.06.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e Departamentit të Rinisë për raportin javor për datat 14-20 Qershor 2024 duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj, me datë 13.06.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e Departamentit të Rinisë për raportin javor për datat 11-13 Qershor 2024 duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj, me datë 23.05.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e Departamentit të Rinisë për raportin javor për datat 17-23 Maj 2024 duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj, me datë 16.05.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e

Departamentit të Rinisë për raportin javor për datat 10-16 Prill 2024 duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj, me datë 25.04.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e Departamentit të Rinisë për raportin javor për datat 19-25 Prill 2024 duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj, me datë 21.03.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e Departamentit të Rinisë për raportin javor për datat 15-21 Shkurt 2024 duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj, me datë 11.04.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e Departamentit të Rinisë për raportin javor për datat 05-11 Prill 2024 duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj, me datë 14.03.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e Departamentit të Rinisë për raportin javor për datat 08-14 Shkurt 2024 duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj, me datë 28.03.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e Departamentit të Rinisë për raportin javor për datat 22-28 Mars 2024 duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj, me datë 18.04.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e Departamentit të Rinisë për raportin javor për datat 12-18 Prill 2024 duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj, me datë 02.05.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e Departamentit të Rinisë për raportin javor për datat 03-09 Maj 2024 duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj, me datë 25.07.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e Departamentit të Rinisë për raportin javor për datat 19-25 Korrik 2024 duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj, me datë 27.06.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e Departamentit të Rinisë për raportin javor për datat 21-27 Qershor 2024 duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj, me datë 18.07.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e Departamentit të Rinisë për raportin dyjavor për datat 08-18 Korrik 2024 duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj, me datë 04.07.2024 përmes e-mailit e ka njoftuar Drejtorin e Departamentit të Rinisë për raportin javor për datat 28 Qershor dhe 04 Korrik 2024 duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj.

Kolegji i Këshillit po ashtu ka konstatuar se ankuesja me datë 23.04.2024 përmes e-mailit i drejtohet Drejtorit të Departamentit të Rinisë si në vijim citoj: *I nderuar z. Bajrami për të hartuar thirrjen publike më duhet të jam e njoftuar lidhur me aktivitetet që duhet të përfshihen në thirrje dhe hollësi të tjera*, duke e mbajtur Cc mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të saj. Ndërsa me datë 29.04.2024 dhe 30.04.2024 përmes e-mailit komunikon direkt me kabinetin e ministrit. Po ashtu me datë 02.05.2024 përmes e-mailit i drejtohet Drejtorit të Departamentit të Rinisë si në vijim citoj: *I nderuar Drejtor Po iu përcjell ftesën e përgatitur nga unë dhe me ndryshimet e bëra nga znj. D.D. këshilltare për Rini*.

Kolegji i Këshillit ka gjetur se me datë 24.04.2023 përmes e-mailit Drejtori i Departamentit të Rinisë ka njoftuar Sekretarin se bazuar në emailin e MFPT e cila kërkon që edhe MKRS të themelojë një task forcë për skemën e garantimit të rinisë (SGR) dhe ka propozuar V.J. koordinator, F.K. anëtare, M.E. anëtare dhe E.B. anëtare. Ndërsa ankuesja me datë 15.04.2024 përmes e-mailit i drejtohet V.J. koordinator i task forcës, se në task forcë është emëruar nga këshilltarja e Ministrit D.D. Ndërsa Koordinatorin e task forcës për Outreach Mobilizim me datë 23.04.2024 përmes e-mailit ka kërkuar plotësim ndryshimin e vendimit për themelimin e task forcës për Outreach Mobilizim duke zëvendësuar znj. M.E. anëtare me znj. Z.S. si anëtare e task forcës për Outreach Mobilizim. Me datë 24.04.2024 me Nr.653/2024 është nxjerrë vendimi nga U.d. Sekretari i Përgjithshëm i MKRS me të cilin në vend të M.E. është caktuar Z.S. anëtare e task forcës për Outreach Mobilizim në kuadër të MKRS. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesja ka bërë dezinformata lidhur me caktimin e saj si anëtare e task forcës për Outreach Mobilizim edhe pse emërimi i saj është bërë nga Drejtori i Departamentit të Rinisë. Po ashtu bazuar në shkresat e lëndës konkretisht e-mailat e cekur si më lartë, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesja pjesën më të madhe të vitit 2024 raportet javore i ka dërguar tek Drejtori i Departamentit të Rinisë edhe pse bazuar në përshkrimin e detyrave të punës konstatohet fakti se e njëjta raporton tek Udhëheqësja e Divizionit për Parandalim dhe Integrim Shoqëror në Divizionin për Parandalim dhe Integrim Shoqëror në Departamentin e Rinisë në kuadër të Ministrinë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, andaj si rrjedhojë e kësaj vërtetohet fakti se e njëjta ka anashkaluar mbikëqyrësen e saj të drejtpërdrejtë lidhur me raportet javore rrjedhimisht nuk ka respektuar hierarkinë institucionale. Kështu që ankuesja ka vepruar në

kundërshtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik gjegjësisht neni 28 paragrafi 1 dhe 2, neni 29 paragrafi ku përcaktohet se “Detyrimi për respektim të ligjit 1. *Detyrimi për respektim të ligjit 1. Zyrtarja/i publik ka për detyrim të respektojë Kushtetutën, ligjin dhe ka për detyrim të mbroj interesin publik dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. 2. Zyrtarja/i publik ushtron detyrat e saj/tij dhe vepron me profesionalizëm, paanësi, mos diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe kodin e etikës*”, “Zyrtarja/i publik ka për detyrim të veprojë në përputhje me urdhrin e marrë nga mbikëqyrësja/i apo zyrtarja/i tjetër me kompetenca kontrolli ndaj saj/tij, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të brendshme të institucionit”.

Andaj Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimi i Formularit të vlerësimit të punës së ankueses, konstaton se nga provat e lëndës të elaboruara si më lartë, arrihet në përfundimin se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen është real, sepse edhe përkundër faktit që ankuesja do të mund të argumentoj të kundërtën e njëjta nuk ka ofruar dëshmi të tilla, kështu që përkitazi me provat e cekura si më lartë, Kolegji i Këshillit, vlerëson se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen është bërë në raport të drejtë me provat e prezantuara dhe gjendjen e fakteve dhe procedurave të parashikuara me dispozitat e nenit 52 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, andaj si rrjedhojë e kësaj, pretendimet e ankueses janë të pabazuara.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.551/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

### Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses, avokatit Faton Fetahu;
- Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.